

SPECIFIKIME PUNIMESH

Elbasn me 31/05/2017

OBJEKTI: “Rikonstruksion i rruges “Sami Baholli” Lagjja ”Visarjon Xhuvani”

PARAMETRAT E RRUGES SOT:

-Gjatesia e rruges 82.5 ml, gjerësia variabel.

VEND-NDODHJA:

- Rruga ndodhet ne lagjen “Visarjon Xhuvani”. Siperfaqja qe po trajtojme **fillon nga intersektimi me rrugen “Janaq Kilica” ne Perendim dhe me rrugen “Vasil Taja” ne lindje** si dhe kufizohet me pallate dhe shtepi private ne Veri e Jug. Me hollesisht shiko plan vendosjen e ketij rruga.

Drejtimi i rruges eshte: Perendim – Lindje.

GJENDJA E RRUGES SOT:

- Rruga ne fjale eshte e amortizuar, pa shtresa, pa bordura, pa kuneta etj.

INFRASTRUKTURA EKZISTUESE:

- **K.U.Z.** ekzistuese kalon pergjate rruges ne ate pjese qe ka (shiko me kujdes fleten perkatese te konfirmuar nga specialistet e U.K.E. se bashku me shenimet).

-**Pozicioni i Rrjetit ekzistues te KUZ, si dhe linja e re PE qe do te ndertohet** eshte paraqitur ne planimetrine qe na dergon U.K.E. Shiko me kujdes shenimet perkatese. Te behet kujdes i vecante gjate punimeve te germimit. **Pra para fillimit te punimeve duhet te njoftohet UKE, dhe te kontaktohet me specialistet e kompanise(dega teknike) dhe me pas te filloje trajtimi i rruges sipas Projektit.**

-**Pozicioni i linjave telefonike** para fillimit te germimeve firma zbatuese te vihet ne kontakt me specialistet e ALBTELEKOM.

-**Pozicioni i linjave elektrike** para fillimit te punimeve firma zbatuese te vihet ne kontakt me specialistet e ndermarrjes Elektrike. Persa i perket ndricimit ai eshte egzistues.

- **Prandaj para fillimit te punimeve te shikohen me kujdes te gjitha hollesite per te mos demtuar rrjetin inxhinjerik, gjithashtu te njoftohen dhe te kontaktohet me ndermarjet perkatese per arsye sigurie. Vecanerisht gjate kryerjes se punimeve per ndertimin e K.U.Z. ne segmentin e dhene te rruges, eshte e domosdoshme prania dhe konsultimi me specialistet perkates te U.K.E.**

PERSHKRIMI I PUNIMEVE QE DO TE KRYHEN:

Per Rikonstruksion dhe sistemim e rruges te pallateve ne baze te Detyres se Projektimit, do te kryhen keto punime :

Punimet qe do te kryhen

-Germim dheu per bordure + kunete + sip qe shtrohet me beton, konsiston ne germimin e dheut per krijimin e folese ku do te montohen bordurat p.f. 15*35cm, kunetat, si dhe per shtresat e zones qe do te shtrohet me beton.

-Shtrese zhavorri nen bordure + kunet + ne zonen qe do te shtrohet me beton + ne trotuare, konsiston ne realizimin e shtreses me zhavorr me trashesi = 20 cm nen shtresen e betonit te bordurave, kunetes dhe te zones se shtruar me beton.

-Shtrese betoni nen bordure + kunete + ne zonen qe do te shtrohet me beton, konsiston ne realizimin e shtreses se betonit M-150, per lidhjen e bordurave, per jastek te kunetes dhe si shtrese ne zonen qe shtrohet me beton. Kjo shtrese behet me trashesi 20cm.

-F.V. bordure p.f. M-200, konsiston ne furnizimin dhe vendosjen e bordurave p.f. 15*35cm e p.f. 10*30 cm per konturimin e rruges. Ne cdo prag shtepie si dhe aty ku e kerkon komuniteti, bordurat do te vendosen te shtrira.

-Betonim kunete monolite b=40cm, beton M-200, konsiston ne derdhjen e betonit M-200, konform detajit teknik te dhene ne fleten perkatese te projektit.

Trupi i rruges do te **trajtohet me shtresa te plota.**

-Do te realizohet germimi i trupit te rruges konform profileve terthore dhe gjatesore, dhe vendosja e shtresave te plota si me poshte:

-Shtrese zhavorri 20cm per taban rruge+ngjeshje; ngjeshet mire me makineri per te krijuar bazament te qendrueshem.

-Shtrese betoni C20/25 t=15 cm konsiston ne derdhjen ne veper te betonit me klasen e kerkuar per te krijuar shtresen e perdorimit

-Zgare hekuri Φ 6mm konsiston ne lidhjen e zgarave dopio lart dhe posht per te armuar betoni e hedhur ne veper

-Shtrese me tulla rate t=8 cm konsiston ne vendosjen ne veper te tullave me t=8 cm ne kete ze eshte perfshire dhe shtresa e reres prej t=2cm e nevojshme per nivelimin e pllakave

-Shtrese rere per mbushjen e fugave konsiston ne hedhjen ne veper te reres me granulometri te imet e nevojshme kjo per mbushjen e fugave midis pllakave

PUNIME PER NDERTIMIN E K.U.B.

-Germim dheu me eskavator seksion i detyruar, konsiston ne hapjen e kanalit te nevojshem per te shtruar tubot e betonit p.f.me diameter **300mm** ne gjatesine e dhene te kolektorit te ri.

Ketu duhet theksuar se kuotat e sakta te thellesise se germimt per pusetat do te percaktohen ne vend, sepse ato jane te kushtezuara nga kuotat e pusetave ekzistese ne fillim dhe fund te kolektorit,, ne momentin e zbatimit. Ky shenim vlen edhe per kuotat e sakta te thellesise se tubacionit 300mm.

- F.V. tub betoni 300mm, konsiston ne realizimin e linje se re te K.U.B. conform K.T.Z.

- Mbushje + ngjeshje me zhavor konform detajit ne prerjet e kolektorit, konsiston ne mbushjen me zhavor te pjeses se mbetur te kanalit pas montimit te tubove, ngjeshjen shume te mire te tij dhe ne prani lageshtie, per te menjanuar uljet gjate shfrytezimit te rruges. Me pas realizohen me rradhe shtresat e projektuara te rruges.

- Ndertim pusetash te reja te ujrave te bardha + zgare 40x60cm me h=100cm. Per nje sistemim me te mire te ujrave te shiut do te shtohen pusetat ub. Vendndodhja e tyre si dhe skema e shkarkimit te ujrave te bardha eshte dhene me flete te vecante ne projekt.

-F.V. tuba betoni p.f. 300 mm per ujrat e shiut, konsiston ne furnizimin dhe vendosjen e tubave te betonit p.f., dhe te realizojne shkarkimin e ujrave te shiut ne pusetat e ujrave te zeza qe ndodhen ne rruge.

-Transport mbeturinash, konsiston ne largimin e te gjitha mbeturinave ndertimore ne vendin e caktuar nga Bashkia.

Punime Elektriku

Rrjeti i ndricimit do te behet si ne projekt. Realizimi i rrjetit te ndricimit do te behet me Ndricules rrugor sodium 250w me shtylle metalike celiku me lartesi h=7m, krahu l=1.5m. Te gjitha shtyllat tokezohen me elektroda xingato h=1.5m dhe me fijet e peste te tokezimit. Ne te gjitha shtyllat vendosen, puseta plastike me kapak ric te forte 40x40x40. Thellesia e shtrirjes se kabllit eshte h=-0.8m dhe te gjitha lidhjet elektrike realizohen ne morseten e shtylles dhe me kablllo 4x10mm², kabell 4x4mm², kabell 4x2.5mm², nga gabina, dhe 4x10mm². me tel 4x1.5mm² do te jete nga bazamenti i shtylles deri te ndricuesi. Distanca ndermjet shtyllave, dhe si pas projektit si ne planimetri te gjitha shtyllat do te, furnizohen nga kabina boks, me kuader elektrik me fotoelement. Ne kuader vendoset 1 automat 32A dhe 1 leshues 32^a. Ndricimet jane te tipit Sodium 250w. Ne rrugen " Sami Baholli" Jane vendosur puseta elektrike te tension 380V ,qe vjen nga gabina boks, qe do te funizohen (Nr Analizes 3.44/1) **Germim dheu me eskavator me zinxhire me kove 0.25m³ per kanale me gjeresi deri 2m toke e zakonshme kategoria III me shkarkim ne mjet (linjat lidhese dhe PUB) do te konsistoje ne : Germimin e seksionit te detyruar per te krijuar hapesiren e nevojshme te kanalit brenda te cilit do te montohen linjat e reja te ujrave te shiut PUB. Ne projekt jane dhene detaje te seksionit te germimit ne faqe te posacme. Pas germimit dherat te shkarkohen deri ne mjet.**

-(Nr Analizes 3/An 55) **F.V pusete elektrike kontrolli pvc kapak te forte RIC 1084+1086** do te konsistoje ne : Blerjen e pusetave dhe fiksimin e tyre me beton ne objekt.

-(Nr Analizes 3.An/et) **F.V elektroda tokezimi profil xingato Cu** do te konsistoje ne : Blerjen e elektrodave te tokezimit dhe morsetave perkatese dhe mgulja e montimi i tyre ne objekt.

-(Nr Analizes 3.An/53) **F.V shtylle metalike per ndricim, H=8M, d=160 mm** do te konsistoje ne : Blerjen e shtylles dhe montimin e saj ne vendet perkatese.

-(Nr Analizes 2.An/129) **F.V ndricues Led 120w, 40w** do te konsistoje ne : Blerjen e ndricuesve dhe montimin e tyre ne shtylla.

-(Nr Analizes 4.133/3.7) **F.V.ne mure e konstruksione kablllo Al fuqie +1000v, me izolim gome e mbulesa plastmasi, i armuar 4x25mm²** do te konsistoje ne : Blerjen e kabllit dhe shtrirjen e lidhjen e tij sipas projektit.

-(Nr Analizes 4.142/1.1) **F.V.kabllo kontrolli Cu te armuar, ne toke, 4x2.5 mm²** do te konsistoje ne : Blerjen e kabllit dhe shtrirjen e lidhjen e tij sipas projektit.

-(Nr Analizes 4.133/3.5) **F.V.ne toke kabllo Al fuqie ÷1000V, me izolim gome e mbulesë plastmasi, te armuar, 4x10mm²** do te konsistoje ne : Blerjen e kabllit dhe shtrirjen e lidhjen e tij sipas projektit.

-(Nr Analizes 3.182/a) **Shtrese rere 10 cm** do te konsistoje ne : Blerjen , transportin dhe shtrimin e reres ne kanal.

-(Nr Analizes 3.654) **F.V tub plasmasi O 100 mm** do te konsistoje ne : Blerjen e tubit dhe muftave dhe montimin e tij ne objekt.

-(Nr Analizes 2.490/1a) **F.V Automat termo/el.manj. diferencial 2P 220V, 10A** do te konsistoje ne : Blerjen e automatit dhe montimin e tij ne objekt.

-(Nr Analizes 3.240) **Beton bazament shtylle beton C16/20** do te konsistoje ne : Blerjen e materialeve si zhavor e cemento dhe pergatithen e betonit dhe hedhjen ne veper pergatitjen e tyre dhe montimin e tyre ne bazamentin e shtylles ndricimit.

-(Nr Analizes).An) **F V kuader komandimi komplet me santeri+fotoelement** do te konsistoje ne : Blerjen e kuadrit komandimit komplet dhe montimin e tij ne veper.

-(Nr Analizes 2.a-93) **Percjelles togezimi bakri CU.S=35mm i zhveshur** do te konsistoje ne : Blerjen e percjellesit dhe montimin e tij ne elektodat e tokezimit dhe kuadrin elektrik.

Shuma e Fuqis qe kerkohet P=1.2 KW. Fuqia qe istalohet P=1KW.

HARTOI

Ing.Arian BAKU

Ing.Ejona QAFLESHI

Ing.Irma GJOSHI

Ing. Nazmi TANUSHI

Ing. Kleodian BIXI



DREJTORI

Ark. Gentian TABAKU

**MIRATOHET
KRYETARI
QAZIM SEJDINI**